



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.609/9 prot.

Datë 25.03.2024

**V E N D I M**

**Nr. 297/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.03.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ermal Gjoza” P.F, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-94718-02-07-2024, me objekt: “Lëndë Djegëse (Pelet)”, me fond limit 4,288,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 19.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Ermal Gjoza” P.F, me NIPT L26927601B dhe adresë Lagjja 1, Rruga: “Morava”, Zona Kadstrale 1187, Nr. Pasurie 5/536, Bilisht, Korçë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Devoll  
Lagjia Nr. 1 Rruga “24 tetori” Nr.9, Bilisht, Devoll.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-94718-02-07-2024, me objekt: “Lëndë Djegëse (Pelet)”, me fond limit 4,288,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 19.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

II.2. Në datën 19.02.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 29.02.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alba Pallets & Pellets” SHPK	2.888.888 lekë	Skualifikuar
2. “AL- MEXËOOD” SHPK	3.618.000 lekë	Kualifikuar
3. “Arteo 2018” SHPK	3.845.800 lekë	Kualifikuar
<b>4. “Ermal Gjoza” P.F.</b>	<b>3.200.000 lekë</b>	<b>Kualifikuar</b>
5. “EURO-DECOR” SHPK	3.850.000 lekë	Skualifikuar
6. “Eva Zoto” SHPK	3.350.000 lekë	Kualifikuar
7. “IGLI PELLETT” SHPK	4.288.000 Lekë	Kualifikuar
8. “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK	3.631.400 Lekë	Kualifikuar
9. “Valter Bardhi” P.F.	3.216.000 Lekë	Skualifikuar

II.4. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor në datë 29.02.2024, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të kërkesës “Kërkesë për dokumentacion”, ka njoftuar operatorin ekonomik “Ermal Gjoza” P.F. ku citon: *“Autoriteti Kontraktor Bashkia Devoll ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: Pelet”, në të cilën pas vlerësimit të procedurës ju jeni renditur në vendin e parë. Për sa më sipër ju ftojme të paraqisni pranë Bashkisë Devoll brenda 5 ditëve dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve dhe atë të deklaruar në formularin vetpërmbledhës të deklarimit në formë fizike origjinale ose të noterizuar”.*

II.5. Në datën 06.03.2023, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Referuar raportit të auditit, operatori ekonomik “Ermal Gjoza” P.F. rezultoi i skualifikuar me arsye si më poshtë: *“-KVO në datën 29.02.2024 nepermjet SPE i kërkoi ofertuesit ”ERMAL GJOZA” Person Fizik, të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-Nr. 285, datë 19.5.2021 ”PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” (e ndryshuar), si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.. sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*-Operatori Ekonomik “ERMAL GJOZA” Person Fizik, në datë 01 / 03 2024 dorëzoi dokumentacionin fizik pranë institucionit Bashkia Devoll, ku nga verifikimet rezultoi se OE nuk*

*ka paraqitur dokumenta për të provuar se përmbush informacionin e Formularit të Vetedeklarimit, si më poshtë;*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*\*Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, sipas përcaktimeve të nenit 92 të LPP*

*-Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

II.4. Në datën 10.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2024/3885 dhe me nr. protokollit 609/2024, datë 11.03.2024, e operatorit ekonomik “Ermal Gjoza”P.F., duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 609/2, datë 12.03.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes.

II.6. Me memon nr.609/3 prot., datë 20.03.2024, i është kërkuar Sektorit të Financës (këtu) informacion, nëse operatori ekonomik ankimes “Ermal Gjoza”P.F., ka paraqitur apo jo pranë KPP, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës për ankesën e paraqitur për procedurën objekt - ankimi.

II.7. Me shkresën nr. 799/1 prot., datë 20.03.2024 protokolluar me tonën me nr.609/4 prot., datë 21.03.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar, nëpërmjet postës elektronike, në Komisionin e Prokurimit Publik, *Vendimin nr.12, datë 20.03.2024 “Për mosfillimin e shqyrtimit të ankesës*

së OE “Ermal Gjoza”P.F për procedurën e prokurimit Lëndë djegëse (Pelet)”, si dhe relacionin nr.779 prot., datë 20.03.2024, të të ngarkuarit për shqyrtimin e ankesës. Nga informacioni i mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, me pretendimin se ankesa nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor...

II.8. Me shkresën nr.609/5prot., datë 21.03.2024, Sektori i financës informon se: “ ... Në përgjigje të memos nr. 609/3 prot., datë 20.03.2024- Kërkesë informacioni mbi statusin e pagesës për ankesën me nr.609/2024 prot., datë 11.03.2024 nga "Ermal Gjoza" P.F, ju bëjmë me dije se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës. Janë kryer verifikime me raportin e ardhur me email në datë 21.03.2024 nga Dega e Thesarit për derdhjet e muajit Mars 2024 dhe rezulton që nuk është kryer pagesë nga "Ermal Gjoza" P.F në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar. ”.

II.9. Shkresa nr. 799/1 prot., datë 20.03.2024, protokolluar me tonën me nr.609/6 prot., datë 25.03.2024, nëpërmjet së cilës autoriteti kontraktor ka dërguar, Vendimin nr.12, datë 20.03.2024 “Për mosfillimin e shqyrtimit të ankesës së OE “Ermal Gjoza”P.F për procedurën e prokurimit Lëndë djegëse (Pelet)”, si dhe relacioni nr.779 prot., datë 20.03.2024, të të ngarkuarit për shqyrtimin e ankesës, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar. Nga informacioni i mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, me pretendimin se ankesa nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor...

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

#### Arsyeton:

III.I. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, vlen të theksojmë, se për sa i përket pretendimit të autoritetit kontraktor të paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku informon se: “[...] ankesa nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor[...] sqarojmë, se operatori ekonomik “Ermal Gjoza”P.F ka paraqitur ankim në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave.

Sa më sipër, vlen të theksojmë, se që në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar sistemin e Regjistrimit Elektronik të Ankesave, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin

elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Ankesave.

Në këtë kuadër, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, është kryer një cikël trajnimesh falas, në 12 qarqe të Shqipërisë, ku janë ftuar të marrin pjesë të gjitha institucionet të cilat zhvillojnë procedura prokurimi, si dhe operatorë ekonomikë, të cilët janë njohur mbi mënyrën e funksionimit dhe përdorimit të këtij sistemi. Akoma më tej, më datë 11.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, përmes komunikimit elektronik zyrtar, e ka njoftuar autoritetin kontraktor për paraqitjen e ankesës së sipërpërmendur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për kryerjen e disa veprimeve procedurale në sistemin elektronik të ankesave me qëllim zbatimin e procedurave ligjore.

Sa më sipër, operatori ekonomik ankimues “Ermal Gjoza”P.F, ka paraqitur ankim në rrugë elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën objekt-shqyrtimi

III.1.1. Në datën 08.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-94718-02-07-2024, me objekt: “Lëndë Djegëse (Pelet)”, me fond limit 4,288,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 19.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

III.1.2. Në datën 19.02.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 29.02.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Alba Pallets & Pellets” SHPK	2.888.888 lekë	Skualifikuar
2. “AL- MEXWOOD” SHPK	3.618.000 lekë	Kualifikuar
3. “Arteo 2018” SHPK	3.845.800 lekë	Kualifikuar
<b>4. “Ermal Gjoza” P.F.</b>	<b>3.200.000 lekë</b>	<b>Kualifikuar</b>
5. “EURO-DECOR”SHPK	3.850.000 lekë	Skualifikuar
6. “Eva Zoto” SHPK	3.350.000 lekë	Kualifikuar
7. “IGLI PELLETS”SHPK	4.288.000 Lekë	Kualifikuar
8. “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK	3.631.400 Lekë	Kualifikuar
9. “Valter Bardhi” P.F.	3.216.000 Lekë	Skualifikuar

III.1.4. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor në datë 29.02.2024, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të

kërkesës “Kërkesë për dokumentacion”, ka njoftuar operatorin ekonomik “Ermal Gjoza” P.F. ku citon: “Autoriteti Kontraktor Bashkia Devoll ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: Pelet”, në të cilën pas vlerësimit të procedurës ju jeni renditur në vendin e parë, Per sa me sipër ju ftojme te paraqisni prane Bashkise Devoll brenda 5 diteve, dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin elektronik te prokurimeve dhe ate të deklaruar në formularin vetepërmbledhës të deklarimit, në formë fizike origjinale ose të noterizuar”.

III.1.5. Në datën 06.03.2023, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Referuar raportit të auditit, operatori ekonomik “Ermal Gjoza” P.F. rezultoi i skualifikuar me arsye si më poshtë: “-KVO ne daten 29.02.2024 nepermjet SPE i kërkoi ofertuesit ”ERMAL GJOZA” Person Fizik, të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 te VKM-Nr. 285, datë 19.5.2021 ”PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” (e ndryshuar), si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.. sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

-Operatori Ekonomik “ERMAL GJOZA” Person Fizik, ne date 01 / 03 2024 dorezoi dokumentacionin fizik prane institucionit Bashkia Devoll, ku nga verifikimet rezultoi se OE nuk ka paraqitur dokumenta per te provuar se permbush informacionin e Formularit te Vetedeklarimit, si me poshte;

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

\*Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, sipas përcaktimeve të nenit 92 të LPP

-Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

III.1.4. Në datën 10.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2024/3885 dhe me nr. protokollit 609/2024, datë 11.03.2024, e operatorit ekonomik “Ermal Gjoza”P.F., duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 609/2, datë 12.03.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

III.1.6. Me memon nr.609/3 prot., datë 20.03.2024, i është kërkuar Sektorit të Financës (këtu) informacion, nëse operatori ekonomik ankimues “Ermal Gjoza”P.F., ka paraqitur apo jo pranë KPP, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës për ankesën e paraqitur për procedurën objekt-ankimi..

III.1.7. Me shkresën nr. 799/1 prot., datë 20.03.2024, protokolluar me tonën me nr.609/4 prot., datë 21.03.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar, nëpërmjet postës elektronike, në Komisionin e Prokurimit Publik, *Vendimin nr.12, datë 20.03.2024 “Për mosfillimin e shqyrtimit të ankesës së OE ‘Ermal Gjoza’ P.F për procedurën e prokurimit Lëndë djegëse (Pelet)”*, si dhe relacionin nr.779 prot., datë 20.03.2024, *të të ngarkuarit për shqyrtimin e ankesës*. Nga informacioni i mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, me pretendimin se ankesa nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor...

III.1.8. Me shkresën nr.609/5 prot., datë 21.03.2024, Sektori i financës informon se: “ [...] Në përgjigje të memos nr. 609/3 prot., datë 20.03.2024 - Kërkesë informacioni mbi statusin e pagesës për ankesën me nr.609/2024 prot., datë 11.03.2024 nga "Ermal Gjoza" P.F, ju bëjmë me dije se nuk është paraqitur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës. Janë kryer verifikime me raportin e ardhur me email në date 21.03.2024 nga Dega e Thesarit për derdhjet e muajit Mars 2024 dhe rezulton që nuk është kryer pagesë nga "Ermal Gjoza" P.F në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”.

III.1.9.Shkresa nr. 799/1 prot., datë 20.03.2024 protokolluar me tonën me nr.609/6 prot., datë 25.03.2024, nëpërmjet së cilës autoriteti kontraktor ka dërguar, *Vendimin nr.12, datë 20.03.2024 “Për mosfillimin e shqyrtimit të ankesës së OE “Ermal Gjoza”P.F për procedurën e prokurimit Lëndë djegëse (Pelet)”*, si dhe relacionin nr.779 prot., datë 20.03.2024 *të të ngarkuarit për shqyrtimin e ankesës*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar. Nga informacioni i mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, me pretendimin se ankesa nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor...



III.1.10. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se në datën 10.03.2024, datë në të cilën operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë nëpërmjet SPE, autoriteti kontraktor nuk ka publikuar as njoftimin e fituesit, as njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

III.1.11. Neni 111, pika 1, i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”*

III.1.12. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikojnë se: *“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”*

III.1.13. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “Ermal Gjoza” P.F, ka dorëzuar në datën 10.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesën me numër ankimi elektronik 2024/3885, protokolluar me nr.609/2024, datë 11.03.2024. Ndërkohë nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor në këtë datë, pra 10.03.2024, nuk është publikuar as njoftim - fituesi as njoftimi i anulimit të procedurës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*, pasi në datën 10.03.2024 (data që operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën në SPE), nuk ishte publikuar as njoftim fituesi as njoftimi i anulimit të procedurës.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, më datë 10.03.2024, afati i paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nuk kishte filluar ende, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, apo njoftimi i anulimit të procedurës, që do të thotë se operatorit ekonomik ankimues nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 10.03.2024, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

III.1.14. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ermal Gjoza”P.F, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-94718-02-07-2024, me objekt: “Lëndë Djegëse (Pelet)”, me fond limit 4,288,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 19.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

